

BIBLIOTEKA

94P.65

R 14.

BETEJA E TORVIOLLIT



84P.65

R 14

Kolonel DILAVER RADËSHI

K

31006
~~33079~~

BETEJA E TORVIOLLIT

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»

TIRANË, 1963

Redaktor: Gaço Pisha
Korektor letrar: Astrit Kasimati
Kopertina nga: Dolli Gjinali
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi 3000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-55

Shtyp. N.I.SH: Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë

H Y R J E

Në muajin nëndor të vitit 1443 plasi në Shqipëri një kryengritje e madhe e armatosur kundër pushtuesve turq. Organizatori kryesor i kësaj kryengritje ishte Gjergj Kastrioti — Skënderbeu. Kryengritja që e kombinuar edhe me mësymjen e ushtrive hungaro-polake kundër ushtrive turke në Ballkan, ku këto të fundit pësuan një disfatë të rëndë pranë Nishit, më 3 nëndor 1443. Skënderbeu, i cili kish vajtur atje me forcat shqiptare i thirrur prej turqve, dha një ndihmë shumë të madhe në shpartallimin e ushtrisë turke. Duke qënë në marrëveshje me Haniadin, braktisi në çastin më kritik fushën e betejës dhe me forcat e veta u kthye në Shqipëri, ku me një dekret të rremë, mori në emër të sulltanit Krujën. Marrja e Krujës me dinakëri, që sinjali i shpërthimit të kryengritjes së përgjithëshme shqiptare. Brënda një kohe të shkurtër, Skënderbeu çliroi Principatën e Kastriotëve, Gjergj Araniti mësyti dhe shpartalloi garnizonet turke në Tepelenë, Elbasan, Voskopojë dhe përparoi drejt Maqedonisë; Gjini Zenevizi çliroi krahinën nga Gjirokastra deri në Korgë dhe arriti para Kosturit.

Kryengritësit shqiptarë çliruan brënda një kohe të shkurtër gjithë vendin, me përjashtim të

Kështjellës së Vlorës, Kaninës dhe Gjirokastrës. Shqipëria u çlirua nga zgjedha e huaj dhe u bë e pavarur. Pas dëbimit të turqve nga Shqipëria Skënderbeu organizoi thirrjen e «Kuvendit të Lezhës», ku morën pjesë krerët e gjithë principatave të vendit dhe, si përfundim, formuan «Konfederatën Shqiptare», që bashkonte pjesën më të madhe të teritorit shqiptar.

Kuvendi i Lezhës pati një rëndësi të madhe për bashkimin e popullit tonë në luftë për ruajtjen e pavarësisë dhe të lirisë nga kërcënimi turk. Ai krijoi një ushtri të përbashkët me Skënderbenë si Komandant të Përgjithshëm, si edhe një arkë për financimin e luftës. Të dyja këto masa patën një rëndësi të veçantë për mbrojtjen e Shqipërisë. Turqit nuk mund të pajtoheshin me humbjen e Shqipërisë, pasi donin ta kishin këtë vend si një placdarm për pushtimin e Italisë dhe të Evropës Perëndimore. Skënderbeu e kishte të qartë se, herët ose vonë, ushtritë turke do ta sulmonin Shqipërinë, prandaj ai mori menjëherë masa për organizimin e ushtrisë dhe përgatitjen e vendit për mbrojtje. Dhe kështu ngjau. Sulltan Murati II, pasi përfundoi paqen me hungarezët në qershor të vitit 1444, menjëherë dërgoi një ushtri të madhe për të shtypur kryengritjen dhe për ta pushtuar përsëri Shqipërinë.

Kësaj ushtrie turke Skënderbeu i doli përpara, e tërhoqi me mjeshtëri të madhe në fushën e ngushtë të Torviollit (Domosdovës së sotme) e rrethoi më 29 qershor 1444, dhe e shpartalloi plotësisht. Fitorja e ushtrisë shqiptare mbi ushtrinë turke në Torvioll, pati një rëndësi të veçantë për forcimin dhe farkëtimin e mëtejshëm të bashkimit të popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Skënderbeut.

Fitorja e armëve shqiptare në Torvioll hapi periudhën e luftës ngadhnjimtare njëzetepesëvjeçare kundër shtetit më të madh të kohës, kundër perandorisë turke, dhe forcoi në masat e gjera të popullit tonë besimin se liria mund të ruhej, dhe ushtritë turke mund të thyheshin, nëqoftëse populli shqiptar do të luftonte i bashkuar nën udhëheqjen e birit të tyre të talentuar, Gjergj Kastriotit. Beteja e Torviollit ka rëndësi historike, pasi është hera e parë në histori që shqiptarët luftuan të bashkuar, ku morën pjesë forca nga të gjitha principatat e vendit. Aty luftuan dhe ranë heroikisht krahpërkrah njeri tjetrit për mbrojtjen e At-dheut, që nga malësorët e veriut të principatës së Spanëve, deri tek himarjotët në jugë, që nga fshatarët e Topijasve të Durrësit në perëndim, dhe deri tek ata të Zaharive të Ohrit në lindje.

Për të kuptuar rëndësinë e bashkimit, popullit tonë iu deshën afro 60 vjet luftë të pandërprerë, herë me fitore dhe herë me humbje, kundër pushtimit turk. Periudha, që nga disfata e ushtrisë shqiptare, e cila kish marrë pjesë me besëlidhësit ballkanikë në betejën e Kosovës, më 1389 me Gjergj Kastriotin I dhe Koron Muzakën dhe deri te kryengritja e Beratit, më 1438, që u mbyt me gjak egërsisht nga jeniçerët, u bë një mësim i hidhur, por i vlefshëm për shqiptarët, mbasi nga këto mosuksese ai e kuptoi se për të fituar duhet më parë të jesh i bashkuar.

GJËNDJA E PËRGJITHËSHME USHTARAKE- POLITIKE E TË DY ANËVE NË PRAGUN E BETEJËS

Disfatat e njëpasnjëshme që pësoi në fund të vitit 1443 ushtria turke prej ushtrive hungareze, polake dhe sërbe, kryengritja e Karamanisë në Azinë e vogël, si edhe fitorja e kryengritjes së Skënderbeut dhe dëbimi i ushtrive turke nga Shqipëria, e kishin rrukullisur perandorinë otomane në një gjëndje të vështirë.

Për t'i shpëtuar disfatës së plotë dhe dëbimit një herë e përgjithmonë të turqve nga Ballkani, sulltan Murati II, i cili e shihte qartë se me anën e forcës nuk ishte në gjëndje t'i bënte ballë këtij rreziku, filloi të bënte përçapje dhe të kërkonte paqe me rrugë diplomatike dhe armëpushim të «gjatë» me mbretin e Hungarisë, Vladislavin III.

Për turqit ky armëpushim ishte shumë i nevojshëm, sepse u jepte mundësi të krijonin ushtri të reja dhe të kalonin përsëri në mësymje vendimtare kundër shteteve kundërshtare. Për fillimin e marrëveshjeve, Sulltan Murati II përdori një nga gratë e haremit të tij, Marën, të bijën e princit të Sërbisë, Brankoviçit e cila u bë ndërmjetëse. Sulltani ja arriti qëllimit plotësisht. Mbreti i Hungarisë, Vladislavi III, i shtyrë nga Brankoviçi, vjehri i sulltanit, pranoi paqen e propozuar nga Murati II, duke u besuar fjalëve

se sultani kish çfaqur dëshirën e madhe për të jetuar në «paqë» me shtetet e krishtera të Evropës dhe sidomos me Hungarinë.

Pas bisedimeve të zhvilluara në Buda, Vladislavi III firmoi më 25 prill 1444 aktin, në të cilin renditeshin kushtet që shtetet perëndimore i kërkonin sultanit për të pranuar paqën e propozuar prej tij. Nëpërmjet bisedimeve dhe letërshkëmbimit u arrit marrëveshja për një paqë dhjetëvjeçare midis Hungarisë, Sërbisë, nga njëra anë, dhe Turqisë, nga ana tjetër.

Paqja u nënshkrua zyrtarisht nga të dy palët, më 12 korrik 1444, në Segedin. Murati II hiqte dorë tashti nga sulmet kundër Hungarisë dhe, ndër të tjera, i kthente Gjergj Brankoviçit, që u bë vasal i tij, Sërbinë dhe të gjitha zotërimet që ky mbante në Shqipëri, si Drishtin dhe krahinat në krah të djathtë të Bunës, e të tjera. Sipas paqës së Segedinit, Serbia dhe Herzegovina kalonin nën vartësinë e Sërbisë, dhe Vllahia nën atë të Hungarisë. Përfundimi i kësaj paqeje ishte një fitore e rëndësishme e diplomacisë turke. Sulltan Murati II, mundi të futë një pykë në aleancën e shteteve që i kishin shpallur luftë. Një rol të madh në favor të turqve, lojti princi i Sërbisë, Brankoviçi, i cili pranonte përfundimin e paqës.

Turqit, me anën e kësaj paqeje, fituan kohën e nevojshme për t'u përgatitur për betejat e ardhshme dhe për t'i asgjësuar kundërshtarët e tyre një nga një, ashtu siç vepruan më vonë.

Në traktatin e Segedinit nuk bëhej fjalë as për Shqipërinë dhe as për Karamaninë, që ishin në luftë kundër Turqisë, dhe, siç dihet, pikërisht paqë kësaj paqeje sultani filloi veprimet luftarake kundër këtyre dy vendeve.

Në korrik 1444, duke lënë të birin, Mehmetin, si mëkëmbës në Ervopë dhe si këshilltar të tij, vezir Halil Pashën, sulltan Murati II, me forca të mëdha, kaloi Dardanelet dhe u hodh në Azi për të shtypur kryengritjen e Karamanisë.

Në këtë kohë, Shqipëria ishte futur në muajin e tetë të çlirimit nga zgjedha turke. Brënda kësaj kohe shumë të shkurtër, Skënderbeu kishte punuar me një energji të jashtëzakonëshme për të përballuar mësymjen e ushtrive turke që i prishte. Ai mundi ta bashkonte dhe ta organizonte popullin shqiptar në luftë për mbrojtjen e pavarësisë së vendit. Rreziku turk bëri që mosmarrëveshjet midis princëve të krahinave të ndryshme të vendit të kapërxeheshin për hir të ruajtjes së lirisë.

Skënderbeu ishte i sigurtë se sulltan Murati do ta sulmonte atë shumë shpejt, që të mos i jep-te mundësi të forconte dhe të zgjeronte pushtetin e tij në Shqipëri. Ai parashikonte që ushtritë turke do t'i sulleshin Shqipërisë, porsa të liroheshin nga fronti i Hungarisë. Për bisedimet që zhvilloheshin me inisiativën e sulltanit qysh nga marsi 1444, midis Budës dhe Edrenesë, për përfundimin e një paqeje me Hungarinë, Skënderbeu kishte mundësi të ishte i informuar.

Skënderbeu e kish mbështetur shpresën kryesore për fitore tek shpirti liridashës dhe vetmohonjës i popullit shqiptar, tek bashkimi i gjithë vendit nën një udhëheqje, tek ushtria, të cilën po e përgatiste pikërisht në këtë periudhë. Njëkohësisht ai organizoi një zbulim strategjik në thellësi të madhe në tokën e armikut, gjë që do t'i jepte dorë të mirë në betejat e ardhëshme. Biografët e Skënderbeut shkruajnë se një nga faktorët që

ndikonte në fitoret e shumta të tij, që zbulimi, pasi ai kishte informatorë në tërë tokën turke deri në Edrene, në kryeqytetin e sulltanit.

Një vemendje të madhe Skënderbeu i kushtoi meremetimit të fortesave të vendit, të cilat ishin dëmtuar gjatë luftimeve të vitit 1443, sidomos Krujës, si kryefortesë e Shqipërisë, dhe Sfetigradit (Koxhaxhikut) që mbyllte grykën e ngushtë malore të Drinit të Zi dhe pengonte kalimin e ushtrisë turke në drejtim Ohër-Dibër.

Përveç Krujës, Skënderbeu kishte ndërtuar edhe dy kampe për stërvitjen e ushtrisë: një në Oranik, në fushën e Dibrës së sipërme dhe një në Kashar, në fushën e Tiranës. Si na dëshmon Dhimitër Frëngu, në këto fushime Skënderbeu e mbante ushtrinë në çadra të furnizuara në rregull dhe vazhdonte përgatitjen luftarake të saj.

Në kampin e Oranikut Skënderbeu përqëndrohej atëhere kur mendohej se ushtria turke mund të vinte nga drejtimi i Manastirit, dhe në kampin e Kasharit, kur nuk dihej ende se nga ç'drejtim do të sulmonte ajo.

* * *

Me nënshkrimin e paqës me Hungarinë, sulltan Murati II ndërmoi menjëherë një ekspeditë kundër Shqipërisë. Historiani turk (Ashik-Pasha-Zade, bashkëkohës i sulltan Muratit II, shkruan se ky urdhëroi komandantin e forcave turke të Shkupit, Isa Beun, të sulmonte Shqipërinë. Historianët shqiptarë si Barleci, ashtu dhe Tivarasi i Biemit, shkruajnë se komandanti i ushtrisë turke, që sulmoi Shqipërinë në qershor të vitit 1444, quhej Ali Pasha. Ali Pasha ishte vëllai i Isa Beut. Mundet që Isa Beu nuk shkoi personalisht për të sulmuar

Shqipërinë, por dërgoi të vëllanë, dhe vetë qëndroi me forcat kryesore në Shkup, në gadishmëri për të përballuar, në rast të ndonjë lufte, forcat hungaro-polake, pasi sulltani kishte dijeni mbi përpjekjet e papës për prishjen e kësaj paqeje, gjë që ndodhi në të vërtetë pas disa muajsh.

Ushtria turke, duke u nisur nga baza e saj e Shkupit, kishte mundësi ta sulmonte Shqipërinë dhe ta rrethonte Krujën nga dy drejtime kryesore: i pari Kostur-Korçë-Grykë Shkumbinit-Elbasan-Krujë dhe i dyti: Manastir-Dibër-Tiranë-Krujë. Në këto drejtime është sulmuar herëpashere Shqipëria në kohën e Skënderbeut. Drejtimi i përgjithshëm dhe kryesor ka qënë ai i Grykës së Shkumbinit.

Kur Skënderbeu u informua se ushtria turke do të hynte në Shqipëri nga drejtimi i Manastirit, bëri shikimin rrjeshtor të ushtrisë në Kashar dhe u nis në drejtim të Ohrit. Forcat e Skënderbeut përbëheshin nga 15.000 ushtarë: 8000 kalorës dhe 7000 këmbësorë.

Kjo ishte ushtria kryesore e komanduar nga vetë Skënderbeu dhe do të mbronte drejtimin kryesor në këtë betejë, d.m.th. drejtimin Ohër-Elbasan, kurse forcat e tjera do të mbronin vendin në drejtimet e Prizrendit, Dibrës dhe Beratit.

Skënderbeu kish shumë besim në ushtrinë, në përgatitjen e saj luftarake, në masat e gjëra të popullit që ishin në këmbë me armë në dorë për të mbrojtur Atdheun, dhe në epërsinë e terrenit malor, të përshtatshëm për prita të befasishme dhe rrethimin e ushtrive armike. Barleci vë në dukje se një nga masat që Skënderbeu mori menjëherë, fill pas fitores së kryengritjes, qe edhe studimi i terrenit nga ana ushtarake.

Ushtria e Skënderbeut, në tërësi, nuk kishte përvojë luftimi për beteja të rregullta fushore; por, megjithëkëtë, një pjesë e madhe e ushtarëve kishte marrë pjesë në lufta të ndryshme. Këta ishin ushtarë veteranë, që kishin luftuar kundër pushtuesit turk në kryengritjet e shumta të shqiptarëve, përpara kryengritjes së përgjithëshme të vitit 1443.

Komandantët e ushtrisë së Skënderbeut kishin përvojë luftarake. Një pjesë e tyre ishte nga familjet e mëdha feudale e të njohura, si nga ato të Aranitit, Muzakës, Topisë, Balshës, Dukagjinëve, Spanëve, e të tjerë, si edhe nga shtresat e ndryshme të popullit që kishin qenë vazhdimisht në luftë me armë në dorë. Skënderbeu kishte tre komandantë me përvojë të madhe luftarake. Këta ishin Ajdin Muzaka, djali i motrës së Skënderbeut, Vrana Konti, nga Altisferët e Dajës, dhe djali i vëllait, Hamzaj. Vrana Konti kishte shërbyer më përpara në ushtrinë e mbretit të Napolit, Alfonsit V, ku kishte mësuar artin ushtarak. Ajdin Muzaka, që komandonte këmbësorinë e ushtrisë së përherëshme dhe Hamza Kastrioti, që komandonte kalorinë, kishin qenë në ushtrinë turke dhe kishin fituar një përvojë të madhe luftarake.

FUSHA E TORVIOLLIT

Beteja e Torviollit deri më sot nuk është studiuar. Ajo ka hyrë në historinë e luftrave të Skënderbeut si një betejë e zhvilluar më 1444 kundër një ushtrie turke të komanduar nga Ali Pasha. Sipas Barleci, kjo betejë u zhvillua në Dibrën e Poshtëme dhe sipas Tivarasit, në Torvioll, i cili ndodhet po në Dibrën e Poshtëme. Por nuk është përcaktuar as se ku gjëndet Torvioll dhe as se ku kalojnë afërsisht kufijtë midis dy Dibrave mesjetare, të së sipërme dhe të së poshtme.

Më parë të shohim se ku na drejton Barleci për të kërkuar Dibrën e poshtme dhe pastaj të përcaktojmë vendin se ku u zhvillua kjo betejë e famëshme. Si në mesjetë, ashtu dhe sot, kemi dy Dibra. Në mesjetë kanë qenë Dibra e sipërme dhe Dibra e poshtme, kurse sot kemi Dibrën e vogël dhe Dibrën e madhe.

Barleci shkruan se kjo betejë u zhvillua në Dibrën e poshtme, 80 mijë këmbë nga Kruja, por nuk na thotë se ku ndodhet afërsisht Dibra e Poshtme. Por, kur Barleci flet për Sfetigradin (Koxhaxhikun) që ndodhet 30 km. në veriperëndim të Strugës, në të djathtë të Drinit të Zi, thotë se ndodhet në Dibrën e sipërme, ndërsa për Modriçin, që ndodhet 22 km. në veriperëndim të Strugës, në të majtë të Drinit, thotë se ndodhet në Dibrën e posh-


tme. Barleci na tregon gjithashtu edhe një vend tjetër që gjëndet në Dibrën e sipërme, dhe ky është «Oraniku». Midis Strugës dhe Ohrit, sot kemi një fshat të quajtur Oranik.

Pra, Dibrën e poshtme mesjetare duhet ta kërkojmë në një truall më të gjerë se ai i sotmi. Duke u nisur nga përcaktimi i Barlecit se Dibra e poshtme ishte në kufi të principatës së Kastriotëve, se Modriçi gjëndet në Dibrën e poshtme dhe Sfetigradi në Dibrën e sipërme, vende që janë pothuaj përballë njeri tjetrit dhe i ndan vetëm lumi Drin, mund të mendohet se Drini ka qënë kufiri që ndante të dy Dibrat mesjetare. Krahina që shtrihej në të djathtë të tij, quhej Dibra e sipërme dhe ajo në të majtë Dibra e poshtme. Gjin Muzaka, një bashkëkohës i Skënderbeut, na jep një informatë më të saktë. Ai thotë: «Moisi Golemi quhesh i Dibrës, pasi pronat e tij i kishte në Dibër. Vendi i tij shtrihej në një pjesë të Çermenikës dhe të Mokrës. Kryeqendër kishte Librazhdin dhe sundonte fshatrat Qukës, Dragoshtimë, Dorës, Studën, Gjurin dhe shtëpi të tjera». Këto fshatra ekzistojnë edhe sot në rrethin e Librazhdit. Barleci na thotë gjithashtu se Skënderbeu, pasi çliroj Krujën dhe kësh-tjellat e tjera, shkoi në Dibrën e sipërme për të pritur ushtritë turke dhe, më vonë, zbriti në Dibrën e poshtme, ku u takua me Moisinë.

Duke u mbështetur te Barleci dhe te Muzaka, s'ka dyshim se gryka e Shkumbinit nga Qafa e Thanës dhe deri në Elbasan, ka qënë pjesë e Dibrës së poshtme.

Meqenëse kjo betejë u zhvillua në Dibrën e poshtme, që shtrihej në të majtë të Drinit, vendin e zhvillimit të saj duhet ta kërkojmë nga liqeni i Ohrit, në lindje, dhe deri në Mat, në perëndim;

TORVIOLLI SKEMA N° 1



SHKALLA 1 100.000

nga Drini, në veri, dhe deri në lumin e Shkumbinit, në jug. Para se të fillonte marshimin Skënderbeu e përqëndroi këtë radhë ushtrinë në Kashar të Tiranës. Përqëndrimi i ushtrisë në Kashar për neve ka rëndësi, pasi Skënderbeu, me sa duket, nuk e priste ushtrinë turke nga drejtimi i Dibrës së sipërme, gjatë Drinit, por në drejtim të Dibrës së poshtme, nga ana e Ohrit, gjatë Shkumbinit.

Pasi bëri shikimin rrjeshtor të ushtrisë në Kashar, thotë Tivarasi, Skënderbeu u nis për në Dibrën e poshtme dhe u vendos në një vend të quajtur Torvioll.

Në Shqipëri ka disa vende që quhen Tevoll, Devoll, Torvioll. Në Dibër torviol quhet një copë shesh çair ose luadh që shfrytëzohet për kullotë. Një torviol të këtillë, një shesh e kemi në afërsitë e fshatit Strikçan, në lindje të Zerqanit. Torvioll, quhet gjithashtu një fshat 7 km. në verilindje të Gramshit, si dhe një mal në Shpat me lartësi 1202 m. Por në Torviollet e mësipërme nuk ka mundësi që të zhvillohet asnjë betejë, për shkak se vendi është shumë i thyer dhe nuk ka pozicione të përshtatëshme për një betejë të rregullt fushore dhe as rrugë.

Të shohim tani se ku ndodhet Torvioll i Tivarasit. «Torvioll, — thotë ai, — quhet një fshat me pak shtëpi. Është një fushë e gjërë ranishte dhe e papunuar në Dibrën e poshtme, krejt e xhveshur, pa hendeqe e pengesa, e gjatë rreth 7 milje, e gjërë afro 3 milje dhe shtrihet nga mali Moranit deri në malin e Mokrës. Nga njëra anë kjo fushë ka një kodrinë ose më mirë një lartësi, rrëzë së cilës rrjedh lumi i Shkumbinit. Kjo duhet të shërbente si mbrojtje për krahët e rrjeshtimit të shqiptarëve

kundër morisë së madhe të turqëve, nga ana tjetër fusha përfundonte në dy male me pyje».

Nuk ka dyshim se Torviulli i Biemit është pa tjetër fusha e Domosdovës, pasi në një vend rreth 15-20 km² Biemi na përcakton 7 objekte topografike, që janë edhe sot siç janë përcaktimi i fushës, që është i njëjtë me atë të Domosdovës, mali Maran që sot quhet mali i Moravës, në veriperëndim të fshatit Skënderbe, mbi Rajcë, lartësia ose kodra e Kallukut, lumi i Shkumbinit, dy male: i Skurrës dhe i Llezhit, si edhe mali i Mokrës. Një përcaktim kaq të përpiktë të një vendi mund ta japë vetëm një dëshmitar i ngjarjeve. Për të përcaktuar zhvillimin e kësaj beteje në fushën e Domosdovës, do të mjaftonte vetëm sinjalizimi i malit të Mokrës dhe i lumit të Shkumbinit.

Për të përjetësuar luftat që janë zhvilluar në këtë krahinë, një varg vendesh na kanë mbetur deri më sot me emrin e Skënderbeut. Kjo krahinë është plot me toponime e legjenda që lidhen me emrin e Skënderbeut. Këtu është fshati Skënderbe, shkalla e Skënderbeut në veri të fshatit Rajcë, Qukë: Skënderbe në të majtë të Shkumbinit, si dhe Shpella Skënderbe në jugëperëndim të Berzeshtës. Këto toponime, si dhe gojëdhëna popullore, dëshmojnë se këtu janë zhvilluar luftime me turqit.

Përsa i përket anës taktike, Qafa e Thanës dhe fusha e Demosdovës janë vende shumë të përshtatshme për luftë të befasishme. Nga ana historike, drejtimi Qafë Thanë - Elbasan ka qënë gjatë shekujve drejtimi kryesor i sulmeve të huaja kundër Shqipërisë nga Lindja. Nga ana strategjike, ky drejtim është i përshtatshëm, sepse të fut në thellësi të Shqipërisë dhe të çon në Durrës, në breg-

detin e Adriatikut, më lehtë dhe më shpejt se drejtimet e tjera dhe e ndan Shqipërinë në dy pjesë.

Siç dihet nga burimet historike, sulltan Murati II, më 1450, dhe Mehmeti II, më 1466, 1467 dhe 1478, me forca të mëdha ushtarake, kanë hyrë në Shqipëri po nga ky drejtim.

Në drejtim të Shkumbinit mund të arrihet në Krujë më lehtë e më shpejt, se në drejtim të Dibrës. Drejtimi i Dibrës nuk ka rrugë të përshtatëshme për furnizimin e ushtrisë dhe është i ndërprerë nga një sërë vargmalesh të pakalueshme, siç janë vargu i maleve në lindje të Dibrës së madhe, të Matit dhe në veri të Krujës.

Duhet pasur parasysh edhe një faktor tjetër me shumë rëndësi, se vendet përreth luginës së Drinit të Zi, që prej Strugës e deri në Dibër, dhe rreth luginës së lumit të Radikës, që prej Gostivari deri në afërsitë e Dibrës, janë dy drejtime jo të përshtatëshme për veprime luftarake, nga njera anë dhe, nga ana tjetër, turqit nuk mund të futeshin thellë në drejtim të Dibrës dhe të linir pas shpine garnizonin e fortë të Skënderbeut, Sfetigradin.

Duke u mbështetur në të dhënat e Tivarasit, që përputhen plotësisht me emrat e vendeve rreth fushës së sotme të Domosdovës, duke studiuar edhe terrenin në vend, si dhe të dhënat e burimeve letrare turke që do të shohim më poshtë; ne arrijmë në përfundimin se fusha e Torviollit të Tivarasit, është fusha e sotme e Domosdovës.

PLANET E TË DY ANËVE

Strategjia e Skënderbeut ishte një strategji aktive, që i përshtatesh kushteve të Shqipërisë. Shpresat e fitores, për asgjësimin e forcave të gjalla të kundërshtarit Skënderbeu nuk i varet tek kështjellat siç veprimeve asokohe në Evropën Perëndimore, por në forcat që vepronin jashtë tyre.

Se si e kuptonte Skënderbeu strategjinë ushtarake, ne do ta shohim që në betejën e parë me turqit. Ai nuk i përqëndroi forcat kryesore rreth fortesës së Sfetigradit, nuk u orvat të tërhiqte ushtrinë turke atje, që të luftonte duke pasur fortesën si mbrojtje, por e tërhoqi atë atje ku donte ai vetë, atje ku i dha betejë e i shkaktoi disfatë të plotë.

Strategjia dhe taktika e ushtrisë turke ishte, si zakonisht, strategjia dhe taktika e ushtrive të mëdha, si ajo e arabëve dhe e mongolëve në Mesjetë. Parimi strategjik i parë i turqve ishte që, me anën e ekspeditave, të grabitnin dhe të shkatërronin zonat fushore të kundërshtarit, për të futur panik dhe tmerr në popullsinë vendase. Parimi i dytë strategjik i tyre ishte, si kudo në Mesjetë, marrja e fortesave me anën e rrethimeve dhe parimi i tretë, betejat e mëdha fushore. Me marrjen e fortesave, turqit e detyronin kundërshtarin të pranonte vasalitetin e tyre. Historia e vendit tonë dëshmon të kundërtën e asaj. Sado që turqit mo-

rën fortesat si ato të Krujës, Beratit, Gjirokastrës dhe Kaninës, ata nuk mundën ta vendosin sundimin e tyre plotësisht dhe përfundimisht në malësitë e Shqipërisë si para luftimeve të Skënderbeut, ashtu edhe gjatë tyre.

Sipas zhvillimit të veprimeve luftarake gjatë betejës, siç na i paraqesin burimet historike të kohës, planet e secilës palë ishin këto:

a) *Plani i Skënderbeut.* Duke u mbështetur në garnizonin e kështjellës së Sfetigradit, të ndalonte kalimin e ushtrive turke gjatë grykës së Drinit për në Dibër, të mbronte me forca të pakta grykën e ngushtë të lumit të Radikës, midis Dibrës dhe Gostivarit, dhe pasi të linte të fshehur në pyjet e fushës së Torviollit këmbësorinë e shumtë, vetë, me kalorinë, të marshonte në drejtim të Ohrit, për t'u ndeshur me ushritë turke që po vinin nga Manastiri. Të futej në luftim, të loste rolin e të mundurit, të tërhiqej me mjeshtri, ta mashtronte armikun, të krijonte kushte të tilla që ta ndiqnin, dhe më në fund, t'i fuste në grykën e ngushtë të Shkumbinit dhe t'i shpartallonte plotësisht ushritë turke.

b) *Plani i komandës turke.* Sipas urdhërit të dhënë nga sulltani, komandanti i trupave turke të Shkupit, Isa Beu, duhej të sulmonte dhe të merrte Koxhaxhikun, ta kthente atë në një bazë ushtarake, dhe më vonë, të vazhdonte luftën për të pushtuar Krujën dhe të nënshtronte përsëri Shqipërinë.

Zhvillimi i veprimeve luftarake të mëvonëshme të bind se që të dy anët kanë bërë llogari dhe parashikime të studiuara mirë nga ana ushtarake për të mundur kundërshtarin.

NDESHJET E PARA ME USHTRINË TURKE DHE TËRHEQJA E SKËNDERBEUT

Skënderbeu, pasi la në Torvioll këmbësorinë dhe prapavijën, me forca të pakta këmbësorie dhe me gjithë kalorinë, kapërxeu Qafën e Thanës, në drejtim të Ohrit, për t'u ndeshur me ushtritë turke.

Siç duket nga zhvillimi i veprimeve luftarake, Skënderbeu i përqëndroi forcat për t'i dhënë goditjen e parë ushtrisë turke midis Strugës dhe Ohrit.

Në drejtim të Ohrit Skënderbeu dërgoi detashmente të përparuara, të përbëra nga njësi të këmbësorisë, të komanduara nga Ajdin Muzaka, dhe reparte kalorie të komanduara nga Moisi Golemi. Detashmentet e përparuara të ushtrisë shqiptare u takuan me pararojën e ushtrisë turke dhe u përleshën me të gjatë 26-27 qershorit. Lufta ndërmyet tyre u zhvillua e rreptë dhe vazhdoi derisa në të mori pjesë një forcë e madhe e ushtrisë turke. Forcat e detashmentit u vunë në rrezik dhe ato do të ishin shpartalluar nga forcat turke, sikur të mos kishte hyrë në luftë vetë Skënderbeu me kalorinë.


Kjo qe ndeshja e parë që Skënderbeu bëri me ushtrinë turke, duke futur në luftë një pjesë të ushtrisë shqiptare. Në këtë luftim ushtria shqip-

tare sulmoi ushtrinë turke, që ishte shumë e madhe në numër. Skënderbeu, meqë nuk mund ta përballonte këtë ushtri të madhe, vuri në zbatim planin e tij: luajti rolin e të «mundurit» e u tërhoq ashtu siç e kishte parashikuar. Tërheqjen e forcave kryesore shqiptare e mbulonte një repart kalorë, i komanduar nga Vrana Konti. Forcat shqiptare nuk u tërhoqën gjatë Drinit, në drejtim të kështjellës së Sfetigradit, për t'u bashkuar me forcat e garnizonit, të cilën gjë mund ta parashikonte edhe komandanti turk, por nëpër Qafën e Thanës në drejtim të grykës së Shkumbinit.

Kur komandanti turk pa se Skënderbeu nuk u mbyll në kështjellën e Sfetigradit, por mori rrugën e Shkumbinit, duket se atij i lindi ideja ta ndiqte këmbakëmbës ushtrinë «e thyer» shqiptare dhe ta asgjësonte atë më parë, për të sulmuar pastaj drejtpërdrejt Sfetigradin. Me ndryshimin e gjendjes, komandanti turk ndryshoi, pra, edhe vendimin e marrë më parë dhe synoi të asgjësonte në fillim forcat e gjalla të kundërshtarit.

Skënderbeu, duke bërë një tërheqje të organizuar dhe duke lënë një pararojë të fortë, kaloi Qafën e Thanës dhe vendosi kampin e vet në fushën e Katjelit, midis lartësisë së Karrikut dhe asaj të Kallukut. Tani Skënderbeu ja arriti qëllimit të caktuar për fazën e parë të luftimeve, duke e tërhequr ushtrinë turke atje ku ai mendonte, në grykën e gushtë të Shkumbinit.

NOESHIA E PARE ME TURQIT SHKALA N° 2



Legjenda

	PERPENDRIMI I USHTRISE TURKE
	PERPENDRIMI I USHTRISE SHQIPTARE
	LENIA EKAMBORSORISE SHQIPTARE NE ODOMSDOY
	MARSHIMI I USHTRISE SHQIPTARE
	MARSHIMI I USHTRISE TURKE
	TERHEQUA E USHTRISE SHQIPTARE
	NOJEKUA E USHTRISE SHQIP. NGA TURRIT
	USHTRIA SHQIPTARE
	USHTRIA TURKE
	KESHTOJELLE

SHKALLA 1:100.000

VENDIMI I SKËNDERBEUT PËR BETEJË TË PËRGJITHËSHME NË TORVIOLL


Vendimin përfundimtar për betejë, Skënderbeu e mori pas një zbulimi dhe studimi të hollësishtëm të pozitave të Torviollit gjatë 27 dhe 28 qershorit. Këtu ai mendonte që, me forca më të pakta, t'i shkaktonte disfatë të plotë ushtrisë turke. Kastrioti ishte i sigurtë se, po t'ja arrinte qëllimit që ta tërhiqte ushtrinë turke në fushën e ngushtë të Torviollit sipas planit të parashikuar, do të korrite pa tjetër fitore, meqë këtu terreni ishte në favor të ushtrisë shqiptare dhe në disfavor të ushtrisë turke. Pozicioni i Torviollit nuk i jepte mundësi ushtrisë turke të manovronte, të bënte krahmarrjen e shpinëmarrjen e ushtrisë shqiptare, pasi nuk e lejonte vendi.

Terreni mbulonte dhe siguronte të dy krahet dhe shpinën e formacionit të luftimit të ushtrisë shqiptare. Krahu e majtë të rrjeshtimit e mbulonin kodrat juglindore të Pishkashit, krahu e djathtë e mbulonte fillimi i malit të Mokrës, dhe shpinën, kodrat e Karrikut dhe të Kallukut.

Ushtria shqiptare e kishte të siguar shpinën e formacionit të luftimit nga goditjet e turqve dhe, në rast mossaksesë, e kishte të lirë dhe të siguar rrugën e tërheqjes.

Për të shpartalluar plotësisht ushtrinë turke në fushën e Torviollit, Skënderbeu kishte vënë në

VENDIMI I SKENDERBEUT NE BETEJENE TORVIOLET



pritë natën e 27-28 qershorit, pas tërheqjes nga Ohri, një forcë prej 3000 kalorësish nën komandën e Hamza Kastriotit, në afërsitë e malit të Llezhit, të Skurrës dhe në fshatin e sotmë Skënderbe, kurse forcat e tjera, 12.000 veta, 7000 këmbësorë dhe 5000 kalorës, i përqëndroi në fushën e Torviollit. Vendimi i Skënderbeut parashikonte që, posa ushtria turke, duke ndjekur praparojën e ushtrisë shqiptare, të dilte në Qafën e Thanës, atëhere edhe ushtria shqiptare të dilte nga kampi dhe të rrjeshtohet për betejë, duke i dalë përpara ushtrisë turke. Pasi beteja të fillonte dhe të ishte në fazën vendimtare, kaloria e fshehur e pritës të sulej befas dhe të godiste në shpinë formacionin e luftimit të ushtrisë turke dhe të zinte Qafën e Thanës, të vetmen rrugë tërheqje për turqit. Një pjesë e këtyre forcave të pritës do të dilnin në drejtim të Strugës, për të ndaluar ardhjen e forcave të reja turke në fushën e betejës. Ky ishte me pak fjalë plani i Skënderbeut për të rrethuar dhe shpartalluar ushtritë turke në fushën e Torviollit.

Në betejën e Torviollit ushtria shqiptare e kish ndërtuar formacionin e luftimit në dy skalione, duke patur edhe rezerva. Në skalionin e parë ish radhitur kaloria, në skalionin e dytë këmbësoria. Në rezervë kishte kalori dhe këmbësori, kurse në forcat e pritës vetëm kalori.

Në kalorinë e pritës Skënderbeu kishte varur shpresat e fitores. Këto forca, në çastin më kritik të betejës, do të godisnin befas ushtrinë turke në shpinë, do t'i prisnin rrugën e tërheqjes, dhe në këtë mënyrë armiku do të rrethohej dhe do të shpartallohej plotësisht.

Në qendër të formacionit të luftimit ishte radhitur ushtria e përherëshme. Ajo ishte më e pre-

gatitur dhe përbëhej nga 1700 kalorës, të komanduar nga Gjergj Balsha dhe 2000 këmbësorë, të komanduar nga Ajdin Muzaka. Këta ishin nën komandën e drejtpërdrejtë të Skënderbeut. Krahu i djathtë kishte 900 kalorës, 1800 këmbësorë dhe komandohej nga Tanush Topia, krahu i majtë kishte 1100 kalorës, 1500 këmbësorë dhe i komandonte Moisiu i Dibrës. Rezervën e kalorësë, të përbërë nga 1300 kalorës, e komandonte Vrana Konti dhe rezervën e këmbësorisë, të përbërë nga 1700 këmbësorë, e komandonte Marin Spani. Forcat e pritës, të përbëra nga 3000 kalorës, ishin nën komandën e përgjithëshme të Hamza Kastriotit.

Duke patur parasysh relievin e terrenit dhe zhvillimin e luftimeve, mund të përcaktohet me saktësi vendosja e kalorësve të pritës. Barleci na thotë se Hamzaj do ta sulmonte armikun dhe do t'i mbyllte atij çdo shteg. Gjatë zhvillimit të luftimit, kur u fut kaloria e Hamzajt në luftë, Barleci na thotë shprehimisht se ajo doli pa vonesë nga pusia dhe sumoi me shpejtësi të madhe armikun.

Kur flet për pozicionin e fushës së Torviollit, Tivarasi shkruan, siç e kemi thënë më sipër, se nga veriu ajo përfundonte në dy male të veshura me pyje, që ne mendojmë të jenë ato të Skurrës dhe të Llezhit. Është e qartë se Skënderbeu kishte vendosur që pikërisht aty të fshihej një pjesë e kalorësë që ta godiste pastaj në shpinë armikun.

Duke u mbështetur në të dhënat që na japin Barleci dhe Tivarasi, kaloria e pritës ka qënë e përqëndruar në dy rajone. Rreth 1500 kalorës ishin përqëndruar në pjerrësitë lindore të maleve të Skurrës dhe të Llezhit dhe pjesa tjetër në pyllin afër fshatit Skënderbej. Këto forca të fundit do të zinin Qafën e Thanës dhe do godisnin krahun e majtë, në shpinë të ushtrisë turke.

Duke pasur parasysh karakterin e terrenit, që e detyronte ushtrinë turke të shpërthente qendrën e ushtrisë shqiptare, Skënderbeu këtu vendosi forcat më të mëdha dhe më luftarake.

Kur ushtria turke arriti në Qafën e Thanës dhe zbriti në fushën e Torviollit, asaj i doli përpara ushtria shqiptare e rrjeshtuar për betejë, e përbërë prej afro 12.000 vetash. Komandantit turk iu duk sikur ja arriti qëllimit, domethënë asgjësimin të plotë të ushtrisë shqiptare.

Ushtria e Skënderbeut, që ishte më se një herë më e vogël se ushtria turke, zinte një vend të vogël në fushë, prandaj komandantit turk iu duk sikur e kishte futur atë në «grackë» dhe mendoi se i duhej vetëm sa të rrjeshtonte forcat e veta dhe, me një sulm të përgjithshëm do ta shpartallonte dhe do ta merrte nëpër këmbë ushtrinë e Skënderbeut.

Ali Pasha kishte nën komandën e vet një ushtri të përbërë prej 25 mijë kalorës dhe këmbësorë. Formacionin e luftimit ai e ndërtoi në dy skalione. Në skalionin e parë radhiti kalorinë dhe në të dytin këmbësorinë. Pasi terreni nuk leonte të bënte kraharrjen ose shpinëmarrjen e ushtrisë shqiptare, Ali Pasha vendosi ta shpërthente qendrën e ushtrisë kundërshtare, ta ndante atë në dy pjesë dhe më vonë ta rrethonte dhe ta asgjësonte. Vendimi i komandantit turk ishte shumë i gabuar, pasi ishte marrë në mbështetje të një gjënjë të rreme të krijuar nga Skënderbeu.

Plani i Skënderbeut në betejën e Torviollit ka qenë një plan i përgatitur me mjeshtri të madhe. Ky plan tregon se Skënderbeu ishte strateg i madh i kohës, që dinte të fitonte me forca të pakta kundër forcave të mëdha.

ZHVILLIMI I BETEJËS

Më 28 qershor 1444, ushtritë turke kaluan Qafën e Thanës dhe zbritën në fushën e Torviollit. Në këtë kohë ushtria shqiptare doli nga kampi i saj dhe u rrjeshtua për betejë. Ali Pasha pikërisht këtë kërkonte, që të zhvillonte një betejë të rregullt fushore me ushtrinë shqiptare dhe urdhëroi që ushtria e tij të rrjeshtohej menjëherë për betejë. Siç njoftojnë burimet, e gjithë gryka e Shkumbinit ziente nga të bërtiturat dhe zhurma e turqve. Në pamje të parë, ushtria turke paraqitej e llahtarëshme e shumë e fuqishme dhe dukesh se që me sulmin e parë do ta shpartallonte ushtrinë shqiptare.

Meqenëse të dy ushtritë u rrjeshtuan me vonesë dhe nuk kishte mbetur shumë dritë, pas pak goditjesh parëndësi, zhvillimi i betejës u la për të nesërmen dhe ushtarët u tërhoqën në kampet e tyre, duke pritur që të hynin në betejë.

Pas rrjeshtimit të ushtrisë shqiptare më 29 qershor, Skënderbeu u foli ushtarëve dhe komandantëve që të kryenin me nder detyrën ndaj atdheut. Ai shkonte kaluar para rrjeshtave të ushtrisë së tij, u fliste me emër ushtarëve dhe oficerëve, u jepte zemër, i porosiste të tregoheshin burra të patrembur në luftën kundër armiqëve të lisë. U kujtonte shqiptarëve se kishte ardhur ças-

ti për t'u hakmarrë kundër turqëve për të gjitha poshtërsitë që kishin bërë në Shqipëri dhe u thosh-te se prindërit dhe fëmijët e tyre, që kishin lënë në shtëpi, prisnin me ankth vetëm lajmin e fitores.

Kjo është një dëshmi e pamohueshme, që vërteton se sa rëndësi i jepte Skënderbeu faktorit moral në luftë. Përpara betejës ai u kujtonte shqiptarëve atdheun, lirinë dhe i ftonte të luftonin trimërisht.


Beteja e Torviollit ndahet në tri etapa. Etapa e parë është ndeshja me kalori dhe këmbësori të armatosur me shigjeta. Kjo ndeshje u bë për të shkaktuar rrëmujë në rrjeshtimet e dy palëve dhe për të zbuluar aftësitë luftarake të ushtrive. Etapa e dytë është afrimi dhe futja në luftë e forcave kryesore të të dy palëve, zbrapsja dhe thyerja e krahut të djathtë të ushtrisë shqiptare. Etapa e tretë është futja në luftë e rezervës, e kalorisë së pritës dhe kundërsulmi i përgjithshëm i ushtrisë shqiptare, rrethimi dhe shpartallimi i forcave turke.

Etapa e parë e betejës

Gjatë natës të 28-29 qershorit, të dy ushtritë qëndruan në kampet e tyre dhe përgatiteshin që të rrjeshtoheshin për betejë, porsa të gdhijej. Barleci na thotë se Skënderbeu i dha urdhër ushtrisë që të hante bukë para se ta nxirte nga kampi për ta rrjeshtuar.

Në agim të 29 qershorit, Skënderbeu e nxori ushtrinë nga kampi dhe sipas vendimit të marrë, e rrjeshtoi për betejë. Sadoqë, në krahasim me ushtrinë turke, ushtria shqiptare ishte afro një

ETAPA E PARE E BETEJES TORVICIOT



SHKALLA 1:100.000

herë më e vogël, Skënderbeu kishte besim të pa-
tundur në fitore. Me fjalimet e tij, ai kishte shtuar
ndjenjat e urrejtjes së shqiptarëve kundër turqve
dhe kish ngjallur tek ushtarët shpirtin e dashurisë
për atdhe dhe të vendosmërisë për ta mbrojtur
atë me luftë o sot o kurrë.

Pak më pas se ushtria shqiptare, doli nga
kampi, dhe u rrjeshtua për betejë edhe ushtria
turke. Në mesjetë ishte pothuajse zakon që koman-
dantët e të dy ushtrive kundërshtarë të mirreshin
vesh për vendin dhe orën e rrjeshtimit për bete-
jë. Ka të ngjarë që për orën e rrjeshtimit për be-
tejë dhe fillimin e saj, Skënderbeu të jetë marrë
vesh me Ali Pashën.

Pas rrjeshtimit të forcave, u zhvillua ndeshja
e vogël me forca të pakta, të nxjerra përpara
rrjeshtimit, të cilat kishin karakter zbulimi e
mashtrimi. Nga të dy anët u turrën përpara skuad-
rone kalorë dhe këmbësorie me shigjeta për të
filluar luftimin.

Forcat turke u sulën përpara dhe u ndeshën
me ato shqiptare. Pas një përleshje të shkurtër,
turqit u tërhoqën me shpejtësi. Kaloria shqiptare
e ndoqi kalorinë turke deri te forcat kryesore. Kjo
ishte një dinakëri që kërkonin të bënin turqit për
ta shpartalluar këtë pjesë të kalorisë shqiptare.
Me këtë ata donin të ngrinin moralin e ushtrisë
turke dhe të kallnin panik në radhët e shqipëtar-
ve. Skënderbeu e kuptoi qëllimin e turqëve dhe
urdhëroi kthimin e kalorisë në vendin e saj në
rrjeshtim. Ndeshjet e para të veçuara me armikun,
para fillimit të betejës së përgjithëshme, u përfun-
duan në favor të forcave shqiptare. Kjo ishte një
shenjë e mirë që tregonte se beteja ishte nisur
mbarë nga ushtria shqiptare.

Etapa e dytë e betejës

Etapa e dytë e betejës filloi menjëherë pas kthimit në vend të forcave të vogla të veçuara, që kishin dalë përpara. Të dy palët filluan afrimin e forcave kryesore për të dhënë betejën e përgjithëshme.

Sulmin e parë e bëri ushtria shqiptare me të gjithë skalionin e parë, të përbërë nga kaloria. Ndërmjet kalorësve të skalionit të parë kishte edhe këmbësorë të armatosur me shigjeta dhe shtiza. Këtë bashkëveprim të drejtpërdrejtë midis kalorisë dhe këmbësorisë, Skënderbeu e kishte paraparë që në marrjen e vendimit për të patur në radhën e parë disa shigjetarë këmbësorë me kalorinë. Detyra kryesore e këtyre këmbësorëve ishte që t'u ndihmonin kalorësve në luftë kundër kalorisë turke. Këta ishin të pajisur me një shtizë që shponte dhe kishte një grep të kthver në majë për të kapur e hedhur poshtë nga shala kalorësin.

Njëkohësisht sulmoi me vrull e me të bërtitura edhe ushtria turke dhe nga të dy anët filloi një përleshje e përgjakëshme.

Turqit sulmuan me rrjeshtat e parë të kalorisë së akinxhinjve, të cilët luftonin kryesisht me shpatë dhe kishin epërsi shumë të madhe në numër. Në kontakt të drejtpërdrejtë me armikun, d.m.th. në skalionin e parë dhe të dytë, Skënderbeu kishte rreth 9000 kalorës dhe këmbësorë. Hamza Kastrioti me 3000 kalorësit e pritës ndodhej i fshehur. Vrana Konti dhe Marin Spani me rezervat, të përbëra nga 1300 kalorës dhe 1700 këmbësorë, ishin të fshehur në pyllin e Katjelit, pas kodrës së Karikut (Kalasë), dhe nuk dukeshin fare nga ana e turqve. Për palën turke kjo krijonte një pamje

sikur këtë grusht shqiptarë, do ta shpartallonte që me sulmin e parë, si e thamë më sipër, prandaj turqit sulmonin me guxim dhe ishin të sigurtë në fitore.


Radhët shqiptare i bënë ballë sulmit të parë të turqëve dhe qëndruan pa u tundur në fushë, duke u mbrojtur me tërbim kundër sulmit të furishëm të kalorisë turke. Ali Pasha, si pa se sulmi i parë i ushtrisë turke nuk pati sukses, futi menjëherë në luftë skalionin e dytë dhe sulmoi me të gjitha forcat.

Ushtria shqiptare nuk mund t'i bënte ballë sulmit të dytë të ushtrisë turke dhe filloi të sprap-sej gjatë gjithë frontit. Për të ndaluar sulmin e kalorisë turke, Skënderbeu futi në luftë skalionet e dyta, si të qendrës, ashtu edhe të dy kraheve. Skalionin e dytë të qendrës e përbënte këmbësoria e përherëshme, e komanduar nga Ajdin Muzaka.

Me futjen në luftë të skalionit të dytë, Skënderbeu e ngadalësoi përparimin e ushtrive turke, por nuk mundi ta ndalonte. Duke patur epërsi të madhe, forcat turke vazhdonin t'i shtynin prapa radhët e ushtrisë shqipëtare. Beteja arriti kulmin e ashpërsimit të saj. Në luftë ranë heroikisht shumë ushtarë e komandantë dhe u shpërndanë disa rrjeshta të ushtrisë shqiptare.

Nga çasti në çast gjendja po bëhej gjithmonë e më kritike. Turqit vazhdonin të sulmonin edhe më me furi kuadratet shqiptare, të cilët po sprapeshin duke luftuar. Rreziku sa vinte e po shtohej për shqiptarët, pasi turqit po i ngushtonin forcat shqiptare në grykën e ngushtë të fshatit Përrenjës, atje ku mbaronte edhe fusha.

ETAPA E DYTE E BETEJES TORVIOLIT



Meqë turqit nuk kishin mundësi të godisnin në krahë dhe në shpinë kuadratet shqiptare, ishin të detyruar të sulmonin vetëm qendrën e saj ku luftonte Skënderbeu me ushtrinë e përherëshme. Këtu në qendër po bëhej përleshja më e madhe dhe më e përgjakëshme. Fushën e luftës e kishin skukur me gjak mijra të vrarë. Midis tyre dhe shumë komandantë shqiptarë si Anton Linjerosa, që komandonte forcat e Labërisë së Aranitit, Marin Igraka, komandant i forcave të Dukagjinit, Pal Kuka dhe Pjetër Spani, komandantë të forcave të malësisë së Shkodrës, Pjetër Strazimiri, Shtjefën Ersiku, etj.


Krahu i djathtë i ushtrisë shqiptare ishte në shpartallim e sipër. Qendra dhe krahu i majtë po i qëndronin me vështirësi furisë së ushtrisë turke. Në këtë gjëndje kritike për ushtrinë shqiptare, Skënderbeu i dha sinjalin kalorisë së pritës të godiste ushtrinë turke nga prapa dhe futi në luftë njëkohësisht edhe rezervat e komanduara nga Vrana Konti dhe Marin Spani.

Etapa e tretë e betejës

Me forcat kryesore të ushtrisë, Skënderbeu po u qëndronte me vështirësi sulmeve të njëpasnjëshme të turqve dhe priste nga një çast në tjetrin që të dilte nga prita Hamzai me kalorinë.

Me të marrë sinjalin, Hamza Kastrioti me 3000 kalorësit e tij doli si vetëtima nga pylli dhe e goditi në befasi të plotë, në shpinë, ushtrinë turke. Kështu filloi etapa e tretë dhe përfundimtare e betejës së Torviollit. Forcat e pritës arriten në kohën e duhur në sheshin e luftës dhe e ndryshuan menjëherë gjëndjen në favor të ushtrisë shqiptare. Ato hynë në luftë në tri drejtime. Nga pjerrësitë

ETAPA E TRETË E BETEJES TORVIQBIT



lindore të maleve të Skurrës dhe të Llezhit, zbriti në drejtim të fshatit Kostraçan, nga pylli i kthesës së përroit të Bistricës, nëpër shkallën Skënderbe, duallë për në drejtim të Rajcës dhe nga fshati Skënderbe në drejtimin e Qafës së Thanës dhe zbritën në fshatin Orak. Këto forca të fundit do të godisnin krahun e majtë të turqëve dhe një pjesë e vogël e tyre do të siguronte rrugën e Strugës. Hamzaj, duke çmuar drejt gjëndjen e krijuar, goditi me shumë forcë krahun e majtë të turqve, sepse në atë drejtim pothuajse ish thyer krahu i djathtë i forcave shqiptare.

Sulmi i rrufeshëm dhe i befasishëm i kalorisë shqiptare në shpinë të rrjeshtimit të ushtrisë turke dhe hyrja e njëkohëshme në luftim e rezervave në krahun e djathtë, kallën panik të madh në radhët e armiqve.

Me futjen në luftë të forcave të pritës dhe të rezervave, kaloi në kundërsulm e gjithë ushtria shqiptare. Tani krahu i djathtë, që i kishte humbur pozitën e para dhe ishte sprapsur më shumë, e rivendosi situatën. Krahu i majtë i ushtrisë turke u shpartallua plotësisht. Ai u godit nga prapa prej kalorisë së pritës dhe në ballë e sulmuar forcat e rezervës.

Kur Moisi Golemi pa se turqit ndalën sulmin e furishëm dhe vetëm po mbroheshin, kaloi në kundërsulm me të gjitha forcat dhe, në bashkëveprim të ngushtë me kalorinë e pritës, e shpartalloi krahun e djathtë të rrjeshtimit turk.

Krahu i majtë dhe i djathtë i ushtrisë turke u thyen, kurse qendra, ku ishte Ali Pasha, mbrohej me këmbëngulje dhe po zmbropste të gjitha sulmet e ushtrisë shqiptare.

Tashti u arrit zbatimi i planit të betejës të parashikuar nga Skënderbeu. Ushtria turke u gjend e rrethuar e tëra prej ushtrisë shqiptare në fushën e ngushtë të Torviollit. Me ajkën e ushtrisë së tij, Ali Pasha kishte formuar një kuadrat të madh, sa të thellë aq dhe të gjerë dhe bënte përpjekje të dëshpëruara për t'i shpëtuar disfatës.

Komandanti i ushtrisë turke kishte bërë një gabim fatal dhe të pandreqshëm. Ai kishte zbritur në fushën e Torviollit pa e siguruar Qafën e Thanës. Një pjesë e kalorisë së Hamzajt zuri Qafën e Thanës dhe i preu rrugën e tërheqjes ushtrisë turke.

Turqit kishin rënë mirë në kurth. Me zënien e Qafës së Thanës nga kaloria e pritës, ishte prerë çdo shpresë shpëtimi për ta.

Ushtria e Skënderbeut sulmoi nga të katër anët. Mezin e ushtrisë turke e godiste me shtiza dhe shigjeta, ndërsa rrjeshtat që ishin afër, i sulmonin kaloria dhe këmbësoria shqiptare.

Skënderbeu me ushtrinë e përherëshme e sulmoi dhe e çau në dy pjesë kuadratin e madh të ushtrisë turke duke sulmuar vetë i pari. Ndarja e ushtrisë turke në dy pjesë krijoi kushtet për ta thyer atë përfundimisht.

Me shpërthimin e kuadratit të madh të ushtrisë turke dhe ndarjen e tij në dy pjesë, mori fund qëndresa e organizuar e armiqve. Ata u shpërndanë dhe ikën grupe-grupe nga i shpinin këmbët. Një pjesë e madhe u asgjësua nga ushtria e Skënderbeut, e cila, përveç fushës së Torviollit, mban-te gjithë lartësinë përreth.

Ushtria turke që kish ardhur për të nënshtruar Shqipërinë kryengritëse, e përbërë prej 25 mijë vetash, e nisur nga Shkupi nën komandën e Ali

Pashës, dhe simbas burimeve turke nga Isa Beu, u shpartallua plotësisht më 29 qershor 1444 në fushën e Torviollit nga ushtria shqiptare e komanduar nga Skënderbeu. Pjesa që mundi të dilte nga rrethimi, iku në panik të plotë. Turqit e humbën betejën e Domosdovës duke lënë në fushën e luftimit 7000 ushtarë të vrarë dhe 500 robër. Humbje të ndjeshme pati edhe ushtria e Skënderbeut. Shqiptarët lanë në këtë betejë rreth 2000 të vrarë dhe po aq të plagosur.

Për rrethimin e ushtrisë turke në Torvioll, përveç Barlecit dhe Tivarasit, kemi një dëshmi edhe nga Ashik-Pasha-Zade, i cili në veprën e përmendur më sipër (fq. 124) na thotë: «Isa Beu shkoi dhe u fut në krahinat e padepërtueshme arnautë dhe pastaj lëshoi akinxhinjtë të plaçkitesj vendi. Kur ai e bëri këtë punë, qafirët e atyre krahinave u prenë rrugët. Një qafir me emrin Iskander, ishte djalë i një sundimtari shqiptar, të cilit sulltani ja kishte lënë atë tokë si timar, kishte qenë Pashë i mbretit (djalë pallati). Pastaj ishte shkëputur prej atij. Akinxhinjve që kishin ardhur me Isa beun, këtë radhë jua kishte prerë rrugën. Kur myslimanët panë rrugën e prerë, i therën robërit dhe luftuan deri sa harxhuan shigjetat dhe derisa u thyen shpatat. Pjesa më e madhe e tyre ngeli aty». Ushtarëve turq të rënë në këtë betejë historiani u kushton një bejte.

*«Pinë verën qetësuese shehitët e fesë
si zoq kaluan nëpër xhenet shehitët e fesë.
Në këtë botë të përkohëshme ata nuk qëndruan
shumë.
Shehitët e fesë u vendosën në pallatin e
përjetësisë.»*

Kjo ndodhi, thotë Ashik-Pashë-Zadeja, më 846 (1444) atë vit u errësua plotësisht dielli.

Rënia e 7000 akinxhinjve në betejën e Torviollit, është shumë e besueshme. Përveç fakteve që sjell Tivarasi dhe Ashik-Pasha-Zadeja, këtu të bind edhe tereni, ku edhe me gurë mund ta asgjësosh armikun e rrethuar.

Në betejën e Torviollit, ushtria turke pësoi disfatën e parë nga ushtria shqiptare, e komanduar nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Një fat i tillë i ndoqi ushtritë turke në Shqipëri për 25 vjet rrjesht, sa herë që synonin ta nënshtronin dhe ta skllavëronin popullin tonë liridashës dhe trim.

RËNDËSIA HISTORIKE E FITORES SË SKËNDERBEUT NË TORVIOLL

Fitorja e Skënderbeut mbi ushtrinë turke në Torvioll pati një rëndësi të veçantë, si për forcimin e autoritetit të «Konfederatës së principatave shqiptare», si dhe për forcimin e bashkimit të popullit shqiptar në luftë për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së vendit kundër rrezikut turk. Jehona e kësaj fitoreje qe e madhe si brënda ashtu edhe jashtë vendit nga njera anë dhe nga ana tjetër, ajo qe një hap përpara në zhvillimin e artit ushtarak shqiptar.

Skënderbeu mundi ta fitonte betejën e Torviollit, sepse ai, në radhë të parë, kish arritur të bashkonte popullin shqiptar nën një udhëheqje të vetme, dhe kjo ishte hera e parë në historinë e vendit tonë që populli shqiptar u ngrit në luftë i gjithë, i bashkuar dhe i organizuar. Kjo fitore gjithashtu ngjalli besimin te populli shqiptar se ai, sado që është i vogël, mund ta dërmojë ushtrinë turke dhe ta mbrojë lirinë e tij, nëqoftëse do të luftojë i bashkuar kundër pushtonjësit të huaj.

Lajmi i fitores së ushtrisë shqiptare në Torvioll u përhap me shpejtësi në të katër anët e Shqipërisë dhe mbushi me gëzim të gjitha zemrat e popullit tonë dhe, me këtë sukses të madh, Skënderbeu siguroi simpatinë dhe admirimin e popullit shqiptar. Masat e gjera popullore të vendit tonë shikonin në personin e Skënderbeut udhëheqësin e tyre të talentuar, i cili do t'i çonte në

fitore të reja, në luftën për liri. Tivarasi na thotë: «Përfundimi i kësaj beteje u dha shqiptarëve të kuptonin se princi i tyre ishte një luftëtar jashtë-zakonisht i shkëlqyer.»

Skënderbeu lavdëroi dhe shpërbleu për heroizmat e kryera gjatë betejës tre ushtarë të thjeshtë si Llesh Beganin, Llazër Farkonin dhe Gjon Ferralin. Kjo veti e dallote shumë Skënderbeun nga udhëheqësit e tjerë feudalë të kohës. Kujdesi që tregonte personalisht për të gjithë, pa harruar edhe të plagosurit, e ngriti shumë figurën e tij në sytë e ushtarëve, jo vetëm si strateg, por edhe si luftëtar e shok i ushtarëve.

Me t'u kthyer në Krujë Skënderbeu u dërgoi letra të gjithë princave të vendit me anë të të cilave i lajmëronte për fitoren. Shumë flamuj lufte turqish iu treguan popullit në kishat. Nga një fitore të tillë, ai vit u quajt viti i lavdishëm.

Fitorja në Torvioll pati shumë rëndësi për forcimin e mëtejshëm të pavarësisë së Shqipërisë. Turqit e kuptuan se në Shqipëri nuk kishin të bënin më me kryengritje të veçuara si më parë, por me kryengritjen e përgjithëshme të popullit shqiptar, të udhëhequr nga Gjergj Kastrioti.

Kjo fitore e Skënderbeut nuk pati jehonë të madhe vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij. Lajmi i saj u përhap në të gjithë Evropën. Për këtë Tivarasi na thotë se «ndjenjat e gëzimit qenë të mëdha tek Papa Eugjeni IV, Vladislavi, mbreti i Polonisë dhe i Hungarisë, tek Filipi, Dukë i Burgonjës, për arsye të lidhjes që ata kishin bërë ndërmjet tyre në atë kohë, për të luftuar kundër turkut. Pasi mori lajmin e kësaj fitoreje si një ugur të mirë të suksesit të planeve të tij... Vladislavi dërgoi tek Skënderbeu një të dërguar me letër,

me anën e së cilës e përgëzonte për shtirjen përsëri në dorë të zotërimit të tij dhe për fitoren e madhe që kishte korrur.

Por, nga ana tjetër, fitorja e Torviollit trembi shumë Republikën e Venedikut. Bashkimi i popullit shqiptar nuk ishte në interes të venedikasve, të cilët parashikonin se nuk do të ishte e largët dita kur Skënderbeu do t'i merrte Venedikut qytetet shqiptare që kishte pushtuar, si Durrësin, Lezhën, Shkodrën dhe Drishtin.

Nga frika e zgjerimit dhe e forcimit të shtetit shqiptar, «në korrik të vitit 1444, Venediku urdhëroi qeveritarin e tij të Korfuzit që të fillonte, në tetor të atij viti, bisedimet me qeveritarët turq në Vlorë, Kaninë e Gjirokastrë, për të zënë këto pika të rëndësishme në mënyrë paqësore, përpara se ato të bëheshin plaçkë e lidhjes shqiptare». Këtë armiqësi të Venedikut kundër shtetit shqiptar e ka vënë në dukje edhe Marksi kur thotë se: «Bashkimi i shqiptarëve ishte një halë në sy për Venedikun».

Fitorja e Lidhjes Shqiptare në betejën e Torviollit, e detyroi republikën e Venedikut të ndryshonte politikën e saj kundrejt Skënderbeut. Pothuajse gjithnjë në të ardhmen Skënderbeu që në gjendje lufte të padeklaruar me Venedikun dhe iu desh t'i bënte ballë kësaj lufte në dy fronte: kundër turqve në lindje, dhe kundër venedikasve në perëndim.

Pas Torviollit turqit filluan të pësonin disfata të njëpasnjëshme në Shqipëri, në luftën e tyre grabitqare. «Fitorja e Torviollit hapi serinë e fitoreve të gjata të pabesueshme të shqiptarëve, të cilat qenë, — thotë Tolariku, — disfatat më të rënda që pësuan turqit në historinë e tyre të gjatë ushtarake.»

PARIMET KRYESORE TË ARTIT USHTARAK NË PËRGJITHËSI NË PRAGUN E LUFTËS SHQIPTARE-TURKE 1443-1468

Për zhvillimin e mëtejshëm të artit ushtarak nga udhëheqësit e shquar, Engelsi na thotë: «Çdo udhëheqës i madh, që krijon një epokë në historinë ushtarake, duke përdorur kombinacione të reja, është ose shpikës i forcave të reja materiale ose i pari që gjen mënyrën e drejtë të përdorimit të forcave jo të njohura para tij» Nën një prizëm të këtillë duhet shikuar dhe zhvillimi i mëtejshëm i artit ushtarak nga Skënderbeu.

Përpara se të shikojmë se ç'të reja gjejmë në fushën e artit ushtarak në betejën e Torviollit, është e nevojshme t'i hedhim një sy kalimthi gjëndjes dhe parimeve të artit ushtarak të ushtërive kryesore evropiane në gjysmën e parë të shekullit XV.

Si pasojë e copëtimit feudal të vendeve në principata të vogla gjatë periudhës së anarkisë feudale, arti ushtarak ishte në një nivel shumë të ulët. Parimet strategjike dhe taktike të Aleksandrit të Maqedonisë, Epaminondës, Pirros, Hanibalit dhe të Jul Qesarit, ishin harruar. Luftat tashti zhvilloheshin kryesisht midis feudalëve të një vendi. Natyrisht, këtu duhet të përjashtojmë pushtimet e arabëve, mongolëve dhe turqve. Engelsi thotë: «Për zhvi-

limin e taktikës, gjithë mesjeta ishte një periudhë e pafrytëshme, e tillë ajo që edhe për shkencat e tjera. Sistemi feudal, ndonse ishte në vetvete një organizatë ushtarake që nga lindja e tij, megjithatë, në thelbin e vet, ai ishte kundër çdo disiplinë». Në Mesjetë, u deshën shekuj për të përsosur armët e zjarrit, metodat dhe formacionin e luftimit të ushtrive.

Në shekullin XV, forcat e armatosura të vendeve evropiane, krijoheshin mbi tri parime kryesore: në ushtrinë feudale, ku çdo feudal ishte i detyruar nga feudali më i madh, princi ose mbreti të paraqitej në luftë me një numër të caktuar ushtarësh bujkrobër, simbas feudës që zotëronte; në ushtritë e tipit të policisë së qyteteve dhe në ushtritë mercenare. Por baza kryesore për plotësimin e ushtrive ishin mercenarët e huaj.

Ushtritë mercenare që luftonin nën flamurin e vendeve të ndryshme, ishin të padisiplinuara. Grabitjet dhe puçet ushtarake ishin fenomene të zakonëshme. Shumë herë, reparte të veçuara kalonin në anën e kundërshtarit dhe ushtarët që binin robër viheshin nën flamurin e atij që i kapte. Ushtritë mercenare kishin një prapavijë të madhe, ato merrnin pas, atje ku shërbenin, gratë dhe fëmijët. Landsknehtët mercenarë gjermanë kishin në dhjetë ushtarë një karrocë, kurse kalorësit, sipas një traktati të vitit 1568, kishin një karrocë për 4-6 ushtarë. Çdo ushtar interesohet vetë për nozullimet e tij. Popullsia që gjindej gjatë rrugës së lëvizjes së ushtrisë ose në zonat e vendosjes së saj, grabitej tmerësisht.

Për ushtritë mercenare Engelsi shkruante kështu: «Ushtritë feudale pushuan se ekzistuari, por krijoheshin ushtri të reja nga një numër i madh

mercenarësh, të cilëve, në agoninë e feudalizmit, iu dha mundësia t'i shërbenin atyre që i paguanin më mirë. Kështu lindi një lloj ushtrie e përherëshme».

Duke filluar nga luftat e Skënderbeut, më 1444, dhe nga vitet e fundit të luftës njëqindvjeçare anglo-franceze ((1337-1453), lindi ushtria e përherëshme kombëtare me rrogë, që luftonte për interesat e mbrojtjes së Atdheut.

Ushtritë e shekullit XV përbëheshin nga kalorëria dhe këmbësoria. Në Evropë akoma mbizotëronte kalorëria e rëndë feudale, e mbuluar kokë e këmbë me pafta metalike, si kalorësi ashtu edhe kali. Kjo kalori mezi lëvizte në fushën e luftës dhe e humbi rëndësinë e saj të përparëshme kur lindi këmbësoria, e aftë për të luftuar kundër kësaj kalorërie. E tillë që këmbësoria e qyteteve të Flandrës, që theu ushtrinë feudale franceze në betejën e Kurtresë më 1302.

Mungesën e manovrimit të kësaj kalorërie të rëndë e njihnin atëhere të gjithë dhe hartonin projekte të ndryshme për të krijuar një lloj kalorërie më të manovrueshme. Shigjetarët kalorës duheshin të mbushnin pjesërisht këtë boshllëk. Në Itali dhe në vendet fqinjë të saj, po gjenin shërbim, në shekujt XI-XVI, «Stratitotët» e kalorësve turq, që përbëheshin nga mercenarët boshnjakë dhe shqiptarë.

Armatimi kryesor i ushtrive në shekullin XV ishte shpata, topuzi, sëpata. Si armë zjarri ishin bombardat dhe armët e lehta të dorës, të cilat ishin në lindje e sipër. Armë zjarri e dorës ishte arkebuti i shekullit XIV, i cili ishte primitiv dhe me cilësi luftarake më të ulta se shigjeta. Në fushën e luftës kjo armë nuk luante asnjë rol, dhe shpesh

herë në luftimet e shekullit XV nuk përmendet fare.

Bombardat, që filluan të duken në fushën e luftës, nuk luanin ndonjë rol, meqë ato nuk mund të zinin pozicionet dhe të bënin zjarr në kohën e duhur. Bombardat mbusheshin nga gryka me vësh-tirësi dhe me vonesë. Nga shkaku i barutit që ishte i dobët, largësia e qitjes ishte shumë e vogël.

«Deri në fund të mesjetës, armët e zjarrit të dorës nuk kishin rëndësi, thotë Engelsi. Kjo ishte e kuptueshme, sepse shigjeta e këmbësorit englez në Kresi, më 1346, qëllonte aq larg, sa edhe arma e këmbësorisë në Vaterlo më 1815. Shigjeta bile mund të ishte më e saktë, ndonëse bënte efekt më të vogël se arma e zjarrit. Havanat fushore ishin pounuajse në kohën e lindjes së tyre, por mund të shponin muret e fortesave».

Si pajime mbrojtëse kalorësit dhe këmbësorët kishin mburoja, përkrenare, parzmorë, këmi-sha metalike, e të tjera.

Mbi rrjeshtimin e ushtrive për betejë, në mes-jetë mund të nxirren të dhëna nga betejat më kryesore të shekullit XV: beteja e Ankarasë midis turqëve dhe Timurlengut, më 1402, e Grynvaldit (Tanenbergut) midis polakëve e letonezëve nga njëra anë dhe gjermanëve nga ana tjetër, më 1410; e Maleshovit midis çekëve të udhëhequr nga Jan Zhishka dhe koalicionit të feudalëve gjermanë, polakë dhe hungarezë, më 1424; e Varnës midis hungarezëve dhe polakëve nga njëra anë dhe turqëve nga ana tjetër, më 1444; e Murtenit midis zvicera-nëve dhe burgonëve më 1476. Me këto mund të arrijmë në përfundim se formacioni i luftimit përbëhej nga kuadrati i tipit falangë, që shtrihej si në front ashtu dhe në thellësi. Këto ishin, siç na tho-

të Engelsi, «Masa të mëdha këmbësorie, të përbëra nga mercenarë të armatosur me shtiza dhe të shtërnguar».

Numri i rrjeshtave në kuadrate dhe sasia e kuadrove, varej nga numri i ushtrive që merrnin pjesë në luftë. Në këtë kohë, luftat në Evropë nuk ishin shumë të përgjakëshme. Betejat zhvilloheshin kryesisht për marrjen e fortesave dhe në luftë vriteshin disa qindra ushtarë, shumë rrallë disa mijra.

Luftat nuk ndiqnin ndonjë qëllim strategjik të madh, por kishin një qëllim politik të caktuar. Ato ktheheshin në fushata plaçkitje midis feudallëve të ndryshëm. Manovrimi dhe bashkëveprimi midis kalorisë, këmbësorisë dhe formacionit luftarak në tërësi, nuk ekzistonte.

Në shumë raste, qëllimi kryesor i luftës ishte zgjidhja e konflikteve midis feudallëve të një vendi ose të vendeve të ndryshme. Anët kundërshtarë, sidomos në Evropën qendrore dhe perëndimore, parashikonin marrjen e ndonjë forte, mbrojtjen e saj ose thyerjen dhe vënien në ikje të forcave kundërshtarë. Natyrisht, gjatë Mesjetës ka patur edhe lufta me karakter të madh, pushtues, si ato të Karlit të Madh, të arabëve, mongollëve, turqve.

Në kohën që studiojmë, ushtria turke ka qenë ushtria më e madhe dhe më e përgatitur për luftë. Kjo ishte e ndarë në tri lloje kryesore: jeniçerë, spahij dhe akinxhij. Jeniçerët ishin formacionet më luftarake dhe më të përgatitura për luftë. Këta kanë qenë ushtria e përhershme, e organizuar në vitin 1326. Kjo ushtri nuk ishte kombëtare, ajo përbëhej nga fëmijë të krishterë të grabitur dhe të mbledhur gjatë fushatave që kryenin turqit. Këta fëmijë që ishin të mitur, edukoheshin me fenë is-

lame dhe përgatiteshin për repartet jeniçere si këmbësorë. Spahijtë ishin kalorës feudalë, të cilët detyroheshin të paraqiteshin në luftë me kalë dhe të armatosur me repartet e tyre, kur i thërriste sulltani. Akinxhinjtë ishin këmbësorë dhe kalorës dhe përbënin pjesën më të madhe të ushtrisë turke. Këta vinin nga shtresat e ndryshme të popullit turk dhe nuk kishin një përgatitje luftarake, përbënin pjesën më të madhe të ushtrisë turke dhe përdoreshin në radhë të parë si pararojë. Në të shumtën e herës, ata dërgoheshin për të terrorizuar dhe për të grabitur vendet që sulmoheshin. Sipas ligjit, akinxhinjtë, një të pestën e pasurisë së grabitur ja dorëzonin sulltanit dhe pjesën, tjetër e mbanin për vete.

Ushtria turke ishte një ushtri masive, strategjia dhe taktika e së cilës ishte krejt e ndryshme nga ajo e ushtrive feudale të Evropës. Baza e strategjisë dhe e taktikës së ushtrisë turke ishte përdorimi në masë i kavalerisë së lehtë, zhvillimi i betejave të mëdha fushore, rrethimi dhe marrja e kësh-tjellave si edhe formimi i kolonive turke në vendet e pushtuara.

Në një gjëndje të tillë zhvillimi ndodhej afërsisht arti ushtarak dhe ushtria e shteteve feudale europiane, kur filloi një nga luftrat më të përgjakshme dhe më përparimtare të Mesjetës, lufta e madhe njëzetepesëvjeçare shqiptare-turke e viteve 1443-1468.

ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I ARTIT USHTARAK SHQIPTAR NGA GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU NË BETEJËN E TORVIOLLIT

Arti ushtarak i ushtrisë shqiptare në betejën e Torviollit që arti ushtarak më i përsosur për zgjidhjen e detyrës së luftës kundër pushtuesit turk, në kushtet e veçanta të Shqipërisë. Ky art ushtarak nuk u krijua atypëraty nga Skënderbeu, por kishte lindur si rrjedhim i luftimeve të gjata shekullore që kishte bërë populli ynë kundër pushtuesve të huaj, sidomos kundër turqve osmanllinj. Si nga organizimi i ushtrisë shqiptare, ashtu edhe nga mënyra e të luftuarit, vërtetohet se ky art ushtarak nuk është i kopjuar as nga ai i lindjes dhe as nga ai i perëndimit. Ky është një art ushtarak thjesht shqiptar, është një art ushtarak origjinal, që ka lindur nga përvoja luftarake e popullit tonë.

Në luftat që udhëhoqi kundër ushtrisë turke, Skënderbeu e përfeksionoi dhe e çoi në një shkallë zhvillimi më të lartë artin ushtarak shqiptar, prandaj me të drejtë ne e quajmë arti ushtarak i Skënderbeut.

Strategjia dhe taktika e betejës së Torviollit të bind se Skënderbeu duhet ta ketë njohur shumë mirë që nga rinia këtë art ushtarak shqiptar. Ka të drejtë Noli kur thotë se, po të ishte rritur Skënder-

beu në Turqi, ai nuk mund të zotëronte aq mirë mjeshhtërinë e zhvillimit të luftës malore. Por njohja e artit ushtarak turk e ndihmoi shumë Skënderbeun për të shtuar aftësitë e tij ushtarake, duke e njohur në themel edhe këtë, për sa kohë që ai qëndroi në ushtrinë turke.

Arti ushtarak i Skënderbeut në betejën e Torviollit ndryshon shumë nga ai i ushtrive feudale të Europës perëndimore dhe të ushtrisë turke. Gjithashtu, edhe ushtria shqiptare, që dërmoi ushtrinë turke në këtë betejë, ndryshonte shumë nga ushtritë e tjera europiane, në të cilat mbizotronin mercenarët. Ushtria shqiptare ishte një ushtri kombëtare, që luftonte për mbrojtjen e interesave të Atdheut. Ajo bënte një luftë të drejtë çlirimtare dhe këtë e thotë në mënyrë shumë të qartë Barleci, kur përshkruan betejën e Torviollit: «Kauza për të cilën u luftua, qe shumë e drejtë dhe e nevojëshme».

Strategjia dhe taktika e Skënderbeut nuk ishin pasive, mbrojtëse, por ishin shumë aktive, mësymëse. Ideja e përgjithëshme e strategjisë së Skënderbeut për mbrojtjen e vendit nga turqit, nuk ishte pritja dhe kalimi në mbrojtje, duke shfrytëzuar fortetat, por dalja larg tyre për të sulmuar dhe shpartalluar ushtrinë turke që në kufijt e vendit. Një parim të tillë strategjik dhe taktik të Skënderbeut ne e shohim që në betejën e parë me turqit, ku ideja kryesore e planit të tij ishte rrethimi dhe asgjësimi i forcave të gjalla të armikut.

Ky parim i të luftuarit për rrethimin dhe njëkohësisht për asgjësimin e armikut, është një hap i ri në zhvillimin e mëtejshëm të artit ushtarak mesjetar. Këtë parim ne nuk e gjejmë në asnjë betejë të mesjetës, në Evropë të zhvilluar në kohën e Skënderbeut.

Për të realizuar planet e tij, Skënderbeu kish-te organizuar një zbulim strategjik në gjithë thellësinë e vendit të armikut. Agjentët e tij gjindeshin jo vetëm në bazat ushtarake turke dhe në rrugët që të çonin për Shqipëri, por edhe në kryeqytetin turk, në Edrene. Si rrjedhim i këtij zbulimi, Skënderbeu dinte jo vetëm përgatitjen e ushtrisë turke për të sulmuar Shqipërinë, por edhe numrin, drejtimin e lëvizjes dhe komandantin e saj. Një zbulim i tillë ishte një armë e fuqishme në duart e Skënderbeut për thyerjen dhe shpartallimin e ushtrisë turke.

Një zbulim të fortë të Skënderbeut ne e shohim qartë me betejën e Torviollit. Këtë radhë Skënderbeu niset nga Kashari i Tiranës në drejtim të Ohrit, sepse, siç duket, ai kishte të dhëna të sigurta se ushtria turke, që ish nisur për të sulmuar Shqipërinë, do të sulmonte në radhë të parë kështjellën e Sfetigradit dhe e dinte se ajo do të vinte nga ana e Ohrit dhe jo nga Gostivari.

Skënderbeu ka qënë krijues në artin ushtarak dhe mjeshtër për të mashtruar armikun. Asnjëra nga luftrat e tij nuk ngjante me njëra tjetrën. Përpara se t'u shkaktonte disfatën përfundimtare ushtrive turke, Skënderbeu i lodhte dhe i gjakoste me goditje të befasishme në kohë dhe vende të ndryshme, ku nuk mund t'i parashikonin komandantët turq, dhe pastaj u jepte goditjen e fundit, me shpartallimin ose asgjësimin e plotë.

Në këtë mënyrë, në radhën e udhëheqësve ushtarakë Skënderbeu nuk ka shok për një mjeshtër të tillë. Këtë cilësi të rrallë ushtarake të Skënderbeut e ka shprehur shumë mirë Richeri, kur thotë: «Skënderbeu ishte i zoti dhe mjeshtër në artin e luftës, që nuk njihej më parë. Kjo arrihej me të tërhequra të ushtrisë, me vendosjen e forcave si duhej, me

prita të befashme dhe me të bërtitura të rrepta, me tërë dinakërinë që mund të shpikte mëndja dhe praktika».

Se ç'taktikë përdorte Skënderbeu për të mashtruar armikun, ne e pamë në betejën e Torviollit. Kjo taktikë e Skënderbeut është e pandarë me një-hjen e mirë dhe shfrytëzimin e terrenit malor. Prapë edhe kjo ishte e panjohur për artin ushtarak të mesjetës në Europë, ku në fushën e luftës delte kaloria e veshur në hekur dhe e paaftë për të lëvizur në vende të thyera dhe malore. Taktika e Skënderbeut nuk ka lindur vetvetiu, por ka dalë nga përvoja luftarake e popullit tonë, nga lufrat kundër pushtesve të huaj, që kishin forca të mëdha ushtarake, kjo është pjellë e vetive luftarake të shqiptarëve, të lindur dhe të mësuar për të luftuar në kushtet e teremit malor.

Artin e stratagemës* shqiptare dhe të shfrytëzimit të terrenit, Skënderbeu me betejën e Torviollit, e çoi, në një shkallë më të përsosur dhe e bëri atë pjesë me rëndësi të artit ushtarak shqiptar.

Formacionin e luftimi që përdori Skënderbeu në betejën e Torviollit, nuk e ka përdorur një udhëheqës tjetër në historinë e lufrave të mesjetës. Ky është një formacion luftimi origjinal. Për të marrë një vendim të tillë për betejë, Skënderbeu ka studiuar me kujdes shumë faktorë me rëndësi, si terrenin, forcat e të dy anëve dhe aftësitë luftarake të tyre.

Po t'u hedhim një sy formacioneve luftarake të betejave të mesjetës, ne nuk do të gjejmë asnjë formacion të tillë me skalion të parë, të dytë, rezerva dhe me forca prite.

* Strategemë quhej arti i të mashtruarit. Sot kjo fjalë nuk përdoret më.

Po të studiojmë me kujdes formacionet luftarake, që nga batalia, formacioni luftarak zvicëran i shekullit XIV, dhe deri tek formacioni i luftimit të brigadës së Makiavelit, teoricien ushtarak i shekullit XVI, ne nuk do të gjejmë ndonjë formacion luftimi të kësaj natyre, të studiuar me hollësi dhe të llogaritur për ta mundur armikun me siguri. Në këtë betejë ishte parashikuar që rolin kryesor për rrethimin dhe asgjësimin e armikut ta luante kaloria e pritës.

Beteja e Torviollit dëshmon se sa rëndësi të madhe i vinte Skënderbeu rezervës dhe forcave të pritës në luftë. Në luftat e kohës së Skënderbeut, në shumë raste rezerva nuk krijohet fare.

Në betejën e Torviollit ka një bashkëveprim të ngushtë midis dy llojeve kryesore të ushtrisë, midis kalorisë dhe këmbësorisë. Këtu parashikohet që, me 1000 nimitin e goditjeve të përbashkëta të kalorësive dhe të këmbësorisë, të thyhet armiku duke pasur një bashkëveprim të ngushtë midis skalionit të parë dhe të dytë, midis rezervave dhe forcave të pritës. Goditja njëherësh e armikut nga forcat e pritës dhe nga rezerva, që pa dyshim një nga kushtet që vendosi fatin e betejës së Torviollit në favor të ushtrisë shqiptare. Siç duket, një rëndësi të veçantë Skënderbeu i kushtonte bashkëveprimit.

Në këtë betejë, Skënderbeu e përgatiti me mjeshtri të madhe kurthin e ushtrisë turke dhe e futi atë brëndë, duke i zënë asaj të vetmen rrugë nga mund të delte në Qafën e Thanës. Skënderbeu, në planin e tij, kishte si qëllim kryesor rrethimin dhe shpartallimin e ushtrisë turke dhe ja arriti qëllimit të caktuar: ushtrinë turke e rrethoi dhe e shpartalloi plotësisht.

Beteja e Torviollit është organizuar sipas një plani të përsosur, ku dëshmohet se Skënderbeu ka qenë një udhëheqës i rrallë për organizimin e luftës.

Rrethimi dhe shpartallimi i një ushtrie të përbërë prej 25.000 ushtarësh, është e pashembullt në historinë e luftrave dhe të artit ushtarak të mesjetës. Ky ishte arti ushtarak i Skënderbeut, për të cilin gjenerali engles Xhejms Uollfi, teoricieni i artit ushtarak të shek. XVIII shkruan: «Nëqoftëse do të mund të nxjerrim një përskrim të mjaftueshëm nga veprimet luftarake të guximëshme të Skënderbeut, kjo nuk do të çmohej dot, se ai shkëlqen midis gjithë komandantëve të vjetër e të rinj.»

Fjalët e gjeneral Xhejmsit janë me vend. Arti ushtarak i Skënderbeut është i pakrahasueshëm me luftrat e ushtrive të tjera të Evropës së asaj kohe.

Njihen botërisht fitoret e pabarabarta të Skënderbeut mbi ushtrinë turke, por nuk janë njohur metodat dhe mënyrat e të luftuarit dhe faktorët që vendosën në ato fitore, nuk është studiuar arti ushtarak i Skënderbeut, nuk është njohur arti ushtarak i tij.

Kjo është orvatja e parë për të studiuar nga ana ushtarake betejën e parë që Skënderbeu fitoi kundër turqëve. Mënyra me të cilën u arrit fitorja e Torviollit na hedh një dritë, në vijë të përgjithëshme, mbi artin ushtarak të Skënderbeut.

Për vetëm pasi të studiohen një nga një të 30 betejat dhe luftrat që zhvilloi Skënderbeu kundër ushtrisë turke për mbrojtjen e Atdheut për 25 vjet rrjesht, ne mund ta njohim artin ushtarak fitimtar të tij.

Fund

BIBLIOGRAFI E PËRDORUR PËR HARTIMIN E KËTIJ PUNIMI

a. Klasikët e Marksizmit

1. Karl Marks: Hronologjëske Zapiskie II. Arhiv Marksa i Engelsa, Moskva, 1939.
2. Frederik Engels: Izbranie Voenie prazvedenie, Moskva, 1937.

b. Burime

3. Anonimi Tivaras: në Biemmi Giammaria, Storia di Giorgi Castriota detto Scanderbegh, Brescia, 1742.
4. Marin Barleci: (1451-1512), Historia del Magnanimo et Valoroso Signor Giorgio Castrioto detto Scanderbeg, denominato Principe degli Albani, Venezia, 1566.
5. Demetro Franco: (vdekur 1512) Gli Illustri et Gloriosi gesti et Vittoriose Imprese fatte contro Turchi Del Signer Don Giorgio Castriotti detto Scanderbeg, Principe d'Epiro, Venegia, 1584.
6. Anonim: I fatti Illustri del Signor Giorgio Scanderbeg, në Sasovino (1521-1586), Historia Universale dell Origine Guerre et Impero dei Turchi, Venetia, 1654.
7. Gin Muzaka: (shek. XV): Historia e genealogia della Casa Musachia (1510), në: Hopf Charles: Chroniques Greco-Romanes, Berlin, 1873.
8. Ashik Pasha-Zade: (1405-1485) Tevarih-i-AI-i Osman-dan, Istanbul, 1918.
9. Dursun beg (shek. XV), Tarih-i-Ebul Fatih, Istanbul, 1914.
10. Kritobullos Imbros (vdekur 1467), Vie de Moharnet II, Budapest, 1875.
11. Pantanus Jovianus (1426-1503) Istoria Neapolitanes 1759 — shih Tolarico.

c. Vepra

12. Babinger Fr. :Ein Erdichtetes Werk über Scanderbeg, in «Forschungen und Fortschritte, Nr. 11, 1934.
13. Babinger Fr. :Die Gründung von Elbasan, Berlin, Walter de Gruyter, 1931.
14. Babinger Fr. :Das Ende der Araniten, München, 1960.
15. Babinger Fr. : Maimetto II Conquistatore e il tempo, München, 1957.
16. Babinger Fr. :Iacopo de promotorios de Campis, München, 1957.
17. Bianco Francesco (Frëng Bardhi): (1606-1643) Relation della Visita di puuch Populi dei Monti di Dukagjina, 1637 (në Bul. Univ. Tiranës, seria Shkencave shoqërore, Nr. 3. 1958).
18. Barbarich Eugenio, Giorgio Castriota lo Scanderbeg, Roma, 1905.
19. Buda Aleks: Fjalim në Koferencën solemne me rastin e 481 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, në «Zërin e Popullit», 20. 2. 1949.
19. Buda Aleks: Fytyra e Skënderbeut në dritën e studimeve të reja: Në Bul. Inst. Shkencave, Nr. 3-4, Tiranë, 1951.
20. Begles Vilson: The Life and letters of James Wolfe, New York, 1909 (shih Noli 1947).
21. Delbruk, Hans: Istorja Voennovo Iskustva v ramkuh politiqeskovo istoria, I, II, Srednjevekovie, Moskva, 1938.
22. Eduart Richer: Jeta e të shkëlqyerve, të krahasuar me njeri tjetrin, Paris, 1802 (shih Oplinga, Nr. 1. Paris, 1920).
23. Frashëri Sami: Shqipëria Ç'ka qenë, Ç'është dhe çdo të jetë, Bukuresht, 1899.
24. Fallmerayer I. Phillip: Das Albanesische Element in Griechenland in Abhandlungen der Historiaschen Klasse der Koeniglich Bagerischen Akademie der Wissenschaften vol. VIII, München, 1860.
25. Fallmerayer, J. Philip: Das Albanische Element in Griechenland, München, 1866.
26. Farlat Daniel: Illyricum Sakrum, Venise, 1817.
27. Francesco Sansóvino: Historia dell' Origine et Guerre de Turchi in Venetia, 1644.
28. Hjrulla Efendi: Dövlət Osmanije Tarihi Dövlət Tarihi, Istambul, 1900.
29. Godart J.: L'Albanie en 1921, Lejan, 1921.

30. Gegaj Athanas: L'Albanie et l'Invasion Turque, XV siècle, Louvain, 1937.
 31. Hopf Charles: Chroniques Greco-Romanes (Memories et Gjin Muzakës) Berlin 1873.
 32. Hammer Purgustall: Storie dell Impero Osmano, Venecia 1928.
 33. Historia e Shqipërisë I Tiranë, 1959.
 34. Inalcik Halil: Fatih devri uzerinde tetkikler ve vesikalar, I, Ankara, 1954.
 35. Marinesco C.: Alphonse V roi d'Aragon et de Naples, et l'Albanie de Skënderbeg, Paris 1923.
 36. Noli, Fan S.: Historia e Skënderbeut, Mbretit të Shqipërisë, Boston, Mass., 1921.
 37. Noli Fan S.: George Castrioti Scanderbeg, Nju-Jork, International University press, 1947.
 38. Noli Fan S.: Historia e Skënderbeut, Kryezotit të Arbërisë, Boston, Mass., 1950.
 39. Ohly Kurt: Eine Gefälschte Retdoltinkunavel, Leipzig, 1933.
 40. Povest O. Scanderbeg, Leningrad, 1957.
 41. Popov P. M.: Albania v rusikij të ukrainskij Litë-raturah, XV, XX veka Kiiiv, 1959.
 42. Pall, Francesco: Marin Barlezio, un Storico e Umanista, Bukurest, 1938.
 43. Pall, Francesco: Une Nouvelle histoire de Scanderbeg (Remarque, sur le livre de M. Gegaj Bukurest 1958).
 44. Pastor, Ludovik: Storia dei papi, Roma, 1928.
 45. Razin, E. A.: Istoria vojenovo Iskustva, II Moskva 1956.
 46. Sirdani Marin: Skënderbeu mbas gojdhansh, Shkodër 1926.
 47. Stokov, A. A.: Istoria Vojenovo Iskustvan, Moskva, 1953.
 48. Tansel S.: Fatih Sulltan Mehmet II, Ankara, 1953.
 49. Talarico, Vincenzo: Vita di Scanderbeg, Firenze, 1943.
 50. Tajani Francesco: Le Istorie Albanesi, Salerno, 1886.
 51. Telpuhovskij B. S.: Severnaja Vojna, Moskva, 1946.
 52. Uruxhi, Adil: Tevarih-i-al-i Osman, Hanver 1935.
- (shih Radonic)
53. Zoidhi Z.: Grekërit dhe fqinjët veriorë 1957 (greqisht).

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje	3
Gjendja e përgjithëshme ushtarake-politike e të dy anëve në pragun e betejës	7
Fusha e Torviollit	13
Planet e të dy anëve	19
Ndeshjet e para me ushtrinë turke dhe tërheqja e Skënderbeut	21
Vendimi i Skënderbeut për betejë të përgjithëshme në Torvioll	24
Zhvillimi i betejës	29
Etapa e parë e betejës	30
Etapa e dytë e betejës	33
Etapa e tretë e betejës	36
Rëndësia historike e fitores së Skënderbeut në Torvioll	42
Parimet kryesore të artit ushtarak në përgjithësi në pragun e luftës shqiptare-turke 1443-1468	45
Zhvillimi i mëtejshëm i artit ushtarak shqiptar nga Gjergj Kastrioti — Skënderbeu në betejën e Torviollit	51

33079

BIBLIOTEKA E SHKËRTIT